



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2021:120370

Datë: 12.03.2024

Numri i dokumentit: 05438521

CP.nr.794/13

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Faton Ajvazi, me sekretaren juridike Makfire Reçica, në çështjen përmbarimore të kreditorit Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, me seli në Prishtinë, rr "...", nr.1, kundër debitorit A.R., pronar i kompanisë N.P.SH.T "R.", me seli në fsh ..., Komuna e Shtimes, për pagesën e gjobës administrative, më datë 12.03.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

I. PEZULLOHET procedura përmbarimore në lëndën përmbarimore CP.nr.794/13, të kreditorit Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, ndaj debitorit A.R., pronar i kompanisë N.P.SH.T "R."

II. Procedura e pezulluar me konkluzion nga paragrafi 1 i nenit 65, të LPP-së, mund të vazhdoj nëse kreditori në afatin prej gjashtë (6) muajsh paraqet informata të reja lidhur me çështjen e pezulluar, në të kundërtën procedura konsiderohet e përfunduar sipas nenit 66, par 1, të LPP-së.

A r s y e t i m

Me aktvendimin CP.nr.794/13, të dt 06.01.2014, kjo gjykatë e ka lejuar përmbarimin e propozuar nga kreditori Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, kundër debitorit A.R., pronar i kompanisë N.P.SH.T "R.", për pagesën e gjobës administrative në shumë prej

14,590.00 euro, si dhe shpenzimet e procedurës, në bazë të gjobës administrative Nr.Prot...., të datës 28.06.2006.

Me qëllim të zbatimit të përmbarimit, Gjykata ka ndërmarr disa veprime në drejtim të përmbarimit të gjobës administrative Nr.Prot...., të datës 28.06.2006, ashtu që më datë 11.03.2024, ka tentuar përmes sistemit të ARBK-së, që të gjej biznese në emër të debitorit edhe atë me numër të biznesit siç është shënuar nga kreditori në propozimin për përmbarim dhe nga rezultati i kërkimit konstatohet se me numër të biznesit të cekur më lart nuk ekziston ndonjë biznes i regjistruar në emër të debitorit.

Po ashtu, gjykata ka kërkuar edhe nga sistemi i Agjencionit të Regjistrimit Civil që të gjej automjete në emër të debitorit dhe nga rezultati i kërkimit rezulton se nuk ka asnjë automjet në emër të debitorit.

Gjithashtu, gjykata ka kërkuar edhe nga sistemi i RPLLB-së, që të gjej edhe llogari bankare në emër të debitorit sipas numrit të biznesit të cekur në propozimin për përmbarim nga kreditori dhe nga rezultati i kërkimit nuk është gjetur asnjë llogari bankare në emër të debitorit N.P.SH.T “R.”.

Gjykata, sa i përket A.R., për të njëjtin, me aktvendimin e datës 29.03.2021, e ka urdhëruar Bankën për Biznes që nga llogaria e debitorit ta transferoj shumën e mjeteve prej 14,590.00 euro, në llogarinë e kreditorit. Mirëpo debitori kundër aktvendimit të cekur më lart ka ushtruar ankesë për parregullsi me pretendimin se biznesi i emërtuar N.P.SH.T “R.”, ndaj të cilës është shqiptuar gjoba në rastin konkret, nuk është në emër të A.R. dhe gjykata me aktvendimin e datës 11.03.2022, e ka pranuar ankesën për parregullsi të autorizuarit të A.R. dhe e ka shfuqizuar në tërësi aktvendimin E.nr.794/13, të datës 29.03.2021 dhe e ka lënë jashtë fuqisë juridike, si dhe me të njëjtin aktvendim me të cilin është pranuar ankesa për parregullsi e ka urdhëruar Bankën për Biznes që t’i deblllokoj llogaritë e debitorit A.R.

Sipas nenit 65, të LPP-së, Ligji nr.04/L-139, është paraparë se përmbarimi pezullohet sipas detyrës zyrtare përveç tjerash edhe në këto rrethana:

1.1 kur debitori apo pasuritë e tij nuk mund të gjenden për qëllim të njoftimit dhe sekuestrimit të pasurisë brenda tre (3) muajve nga fillimi i rastit të përmbarimit, përkundër

faktit se janë bërë së paku dy (2) tentime nga organi përmbaues që të gjej atë person për qëllime të njoftimit apo sekuestrimit të pasurisë,

1.2 kur është tentuar nga organi përmbaues që të zbatohet përmbarimi i vendimit së paku dy (2) herë pa arritur asnjë rezultat të synuar nga këto veprime,

1.3 kur adresa e debitorit e dhënë në propozimin për përmbarim vërtetohet se është e pa saktë ndërsa kreditori nuk mund të argumentoj para organit përmbaues saktësinë e adresës.

2. Procedura e pezulluar me konkluzion nga paragrafi 1 i nenit 65 mund të vazhdoj nëse kreditori në afatin prej gjashtë (6) muajsh paraqet informata të reja lidhur me çështjen e pezulluar, në të kundërtën procedura konsiderohet e përfunduar.

Meqenëse nga shkresat e lëndës u vërtetua se nga gjykata janë ndërmarrë së paku dy (2) veprime me qëllim të përmbaimit të kërkesës së kreditorit dhe deri më tani nuk është realizuar zbatimi i përmbaimit, bazuar në nenin 65, të LPP, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Ndaj këtij konkluzioni në parim nuk lejohet ushtrimi i ankesës.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

CP.nr.794/13, më datë 12.03.2024

G J Y Q T A R I

Faton Ajvazi

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në afatin prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktvendimi.